VENDIM
Nr.104, datë 17.10.2011

PËR TRANSFERIMIN E ASETIT TË "SELCA ENERGY", PËRKATËSISHT "HEC - SELCA" (LËNIE PENG TË ASETIT SI KOLATERAL PRANË BANKËS CREDINS)

Në mbështetje të neneve 9 dhe 20 pika "1", të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 10 pika 3 dhe nenit 11 të "Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit", miratuar me vendimin nr.89, datë 13.12.2006, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, pikave 1.3 dhe 1.6 të licencës "Për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 17.10.2011, pasi shqyrtoi kërkesën për miratimin e transferimit të asetit të shoqërisë "Selca Energy" për lënie peng të asetit si kolateral pranë Bankës Credins, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

- Aplikimi i shoqërisë "Selca Energy" sh.a. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit", si më poshtë:

- Neni 7, pika 1.1 dhe 1.2: Emri dhe adresa e plotë e të licencuarit (Janë paraqitur në mënyrë të plotë dhe korrekte).

- Neni 7, pika 1.3, germa "a", "b", "c", "d", "e", "f", "g", "h": Përshkrimi i të licencuarit dhe informacioni lidhur me aktivitetit e tij (Ky informacion është dhënë i plotë me të gjitha detajet e kërkuara nga rregullorja.).

- Neni 7, pika 2, 3, 4 dhe 5 (Ky informacion është plotësuar tërësisht.)

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë transferimin e asetit të shoqërisë "Selca Energy" sh.p.k. duke pranuar lënien peng si kolateral Hec – Selca, pranë Bankës Credins.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani